

KOLEGJI "BIZNESI"

Nr. 463/20 Data: 02.12.20
PRIZREN



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë

N.N.T. " ETNIKU "

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Neni 1

Palët nënshkruese të këtij memorandumi:

1. Kolegji BIZNESI-Prishtinë, rruga "Motrat Qiriaz" nr 29. të cilën e përfaqëson Dr. Shyqeri Kabashi -Dekan, dhe
2. N.N.T. " Etniku " Adresa: Samadrexhë, p.n. Suharekë, R. e Kosovës, me NRB 811036294.

Neni 2

Qëllimi i këtij Memorandumi

Ky Memorandum bashkëpunimi ka për qëllim përcaktimin e fushave të bashkëpunimit, kushteve dhe afatet themelore, në bazë të të cilave Kolegji BIZNESI- Prishtinë dhe N.N.T. " Etniku " - Suharekë, pajtohen për bashkëpunim.

Neni 3

Fushat e bashkëpunimit

1. N.N.T. " Etniku " - Suharekë do të ndihmojë dhe mbështesë në vazhdimësi Kolegjin Biznesi, në pranimin e studentëve për realizimin e praktikës, dhe dhënjën e sygjërimeve për nevojat e ekonomisë së tregut si pal e interesit nga jashtë, të bazuar në politikat e këtij institucionit.
2. Kolegji Biznesi do të mbështesë në vazhdimësi N.N.T. " Etniku " - Suharekë në aspektin e trajnimeve në fushat: **Menaxhimi i emergjencave** (mbrojtjes nga zjarrit duke kontrolluar dhe servisuar aparaturat për shuarjen e zjarrit), **Ekonomisë** (hartimin e pasqyrave financiare dhe planit të biznesit), **Juridike** (hartimi i kontratave dhe rregulloreve) dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale të personelit.

3. Kolegji Biznesi do të mbështes, N.N.T. " Etniku ". - Suharekë me stafin e sajë akademik, për ligjiërata nga lëmia: Emergjencave, Ekonomis dhe Jurispodencës-sipas nevojave që paraqet N.N.T. " Etniku " - Suharekë.

Neni 4

Interpretimi dhe ndryshimi i memorandumit

1. Interpretimi i këtij Memorandumi do të bëhet në pajtim me Ligjet e Kosovës, duke e ruajtur parimin e reciprocitetit.
2. Afati i këtij memorandumi është në kohë të pacaktuar. Ndryshimet dhe plotësimet e këtij Memorandumi mund të bëhen vetëm me shkrim dhe të nënshkruara nga të dyja palët.

Neni 5

Kopjet e Memorandumit

Memorandumi është punuar në katër kopje origjinale, nga dy kopje për secilën palë.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky Memorandum hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët.

PALËT NËNSHKRUESE

Kolegji BIZNESI Prishtinë


/Prof. Dr. Shyqeri Kabashi/
D e k a n



N.N.T. ETNIKU Suharekë


/Tahir Bugari/
Drejtore



Nënshkruar në Prishtinë, me datë 06/12/2020